



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 22 dhe nenin 20 paragrafi 1 alineat 1 dhe 10¹ nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtueshmëri me nenin 54 paragrafi 4 dhe nenin 104 paragrafi 4 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), lidhur me Propozimin Up1 nr. 08-149 nga 13.05.2022 dhe Propozimin Up1 nr.08-149 nga 17.05.2022 nga mr.Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga ana e drejtorit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në pajtueshmëri me Autorizimin nr.03-1715/1 nga 15.04.2022., dhe në pajtueshmëri me Konkluzionin, ark.nr.02-2019/2 nga 17.05.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 19-të mbajtur më 17.05.2022, miratoi:

V E N D I M
për ndalimin e procedurës së inicuar për marrjen e lejes
për radio transmetim

NDALOHET procedura e inicuar për marrjen e lejes për radio transmetim ndaj Shoqëris tregtare radiodifuzive (SHTR) JON–RADIO SHPK Strug, nr.08-234 nga 30.04.2019, me Propozim Up1 nr.08-149 nga 13.05.2022.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 18-të mbajtur më 16.05.2022., me Konkluzion, ark.nr.02-1980/3 nga 16.05.2022, e miratoi propozimin Up1 nr.08-149 nga 13.05.2022, të Goran Radunoviq, person i autorizuar nga ana e Drejtorit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në pajtueshmëri me Autorizimin nr.03-1715/1 nga 15.04.2022 dhe procedurës së inicuar për marrjen e lejes për radio transmetim ndaj SHTR JON–RADIO SHPK Strug, nr.08-234 nga 30.04.2019, për shkak se pas kryerjes së kontrollit të rregullt administrativ, në Raportin ark.nr.05-1930/1 nga 10.05.2022., u konstatua se radiodifuzeri në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të fakturës e dorëzuar nga Agjencia, nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi 5 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar tarifën vjetore të lejes për radio transmetim ndaj Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Lidhur me këtë, nga ana e Agjencisë më 16.05.2022. drejtuar radiodifuzerit të përmendur u dërgua Shkresë Up1 nr.08-149 nga 16.05.2022., me të cilën u njoftua se nëse nuk paguan tarifën vjetore për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për inicim të procedurës për marrjen e lejes, do të miratoi vendim për marrjen e lejes për transmetim në radio. Shkresa u dërgua tek radiodifuzeri më 17.05.2022, në formë të shkruar nëpërmjet postës së Maqedonisë, edhe në adresë elektronike e regjistruar si kontakt në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku adresa elektronike është evidentuar dhe në Agjencion.

Up1 Nr.08-149

Shkup 17.05.2022.



Agjencia për
shërbime mediatike
audio dhe
audiovizuele

rruga. Makedonija
nr.38
1000 Shkup
Republika e
Maqedonisë së Veriut

Tel. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Më 16.05.2022. drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga ana e Sektorit për finansa dhe logjistik, është dorëzuar Njoftim ark nr.05-1930/2 nga 16.05.2022. se SHTR JON–RADIO SHPK Strug, më 16.05.2022. ka kryer pagesë në shumë prej 285.490,00 (dyqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) denar, me të cilën radiodifuzeri tarifën vjetore për leje të transmetimit në radio e ka paguar në tërësi.

Rrjedhimisht bazuar në këtë, dhe sipas nenit 18 paragrafi 1 alinea 22 dhe nenin 20 paragrafi 1 alinea 1 dhe 10 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në pajtueshmëri me nenin 54 paragrafi 4 dhe nenin 104 paragrafi 4 nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, në lidhje me Propozimin Up1 08-149 nga 13.05.2022 dhe Propozimin Up1 nr.08-149 nga 17.05.2022 nga mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga drejtori i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në pajtueshmëri me Autorizimin nr.03-1715/1 nga 15.04.2022., në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-2019/2 nga 17.05.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, në seancën e 19-të mbajtur më 17.05.2022, vendosi të ndalojë procedurën e inicuar për marrjen e lejes.

Bazuar nga sa më sipër u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuele
Kryetar i Këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Këshillë juridike: Këndër këtij vendimi transmetuesi mund të ngrejë padi për kontest administrativ pranë gjykatës kompetente. Padi për fillimin e kontestit administrativ paraqitet brenda 30 ditësh prej ditës së pranimit të vendimit.

Dorëzuar tek:

- SHTR JON–RADIO SHPK Strug;
- Udhëheqësit të SHTR JON–RADIO SHPK Strug;
- Sektorit për mbështetje informative dhe çështje të përgjithshme – arkivi;
- Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik;
- Sektori për finansa dhe logjistik;dhe
- Personat e emëruar në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për udhëheqjen e Regjistrimit Up 1.

¹ Alinetë 8 dhe 9 janë fshirë, shiko: nenin 8 nga Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).